



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVES-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E SHENDETESISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH	
Njësia Org. Org.Jedinica Org Unit	01
Nr Prot: Prot.Nr.	05-1805
Nr.i faqeve Br.stranica No.pages	- 05 -
Data: Datum: Date:	13/03/2024
Prishtinë / a	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health
Zyra e Ministrit/Ured Ministra/Office of the Minister

Nr.35/III/2024

Datë:12/03/2024

Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të Nenit 145 (pika 2) e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare Nr. 7, 01 Mars 2019), bazuar në nenin 11 të Ligjit Nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, Rregulloren (QRK) Nr.14/2023, për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Shtojca 1 paragrafi 6 nënparagrafi 6.1, lidhur me shkresën Nr. prot. 05-1657, datë 08.03.2024, nxjerrë:

V E N D I M

- I. ~~Miratohet Plani i Veprimit për Zbatim të Udhëzuesit për Zbatimin dhe Monitorimin e Programit Psikosocial me Aktivitete Okupuese për Trajtimin e Rasteve me Probleme të Shëndetit Mendor në Burgje.~~
- II. Shtojcë e këtij vendimi është Plani i Veprimit për Zbatim të Udhëzuesit për Zbatimin dhe Monitorimin e Programit Psikosocial me Aktivitete Okupuese për Trajtimin e Rasteve me Probleme të Shëndetit Mendor në Burgje.
- III. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Dr. Arben Vifta

Ministër i Shëndetësisë



Vendimi i dërgohet:

- Zavendësministrave;
- Sekretarit të përgjithshëm;
- NJSHB;
- DZHSSH;
- Departamentit ligjor;
- Arkivit të MSh-së.

PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E UDHËZUESIT PËR ZBATIMIN DHE MONITORIMIN E PROGRAMIT PSIKOSOCIAL ME AKTIVITETE OKUPUESE PËR TRAJTIMIN E RASTEVE ME PROBLEME TË SHËNDETIT MENDOR NË BURGJE

Ky plan veprimi ka për qëllim specifikimin e veprimeve, aktiviteteve dhe koordinimeve që duhet të ndërmerren me qëllim të fillimit me zbatimin e Udhëzuesi për Zbatimin e Programit Psikosocial me Aktivitete Okupuese për Trajtimin e Rasteve me Probleme të Shëndetit Mendor në Burgje, dhe nuk parasheh implikime buxhetore shtesë për DSHB.

Zbatimi dhe monitorimi i programit do të mundësohet dhe lehtësohet përmes trembëdhjetë aktiviteteve të përmbledhura në katër objektiva kryesore:

1. Përzgjedhja dhe trajnimi i stafit
2. Pilotimi i udhëzuesit në ISHTPNV
3. Zgjerimi i programit edhe në njësitë e tjera shëndetësore të burgjeve
4. Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të programit

Përzgjedhja dhe trajnimi i stafit përfshinë aktivitete e para, të domosdoshme, me qëllim të krijimit të kapaciteteve të mjaftueshme profesionale dhe njerëzore në zbatimin e programit. Ky objektivi është në proces e sipër dhe mbështet nga projekti i Këshillit të Evropës dhe synon të ndërtoj këto kapacitete në secilën njësi shëndetësore të burgut, duke krijuar trajnerë të certifikuar për programin.

Me plotësimin e aktiviteteve në objektiven e parë hapen mundësit për pilotimi i udhëzuesit në ISHTPNV. Pilotimi në këtë institucion duhet të filloj për shkak të parakushteve ekzistuese. Kapacitete e mjaftueshme profesionale, arkitektonik, pajisjet dhe numri i pacienteve të cilët kanë nevojë për shërbimet që ofron Programit Psikosocial me Aktivitete Okupuese për Trajtimin e Rasteve me Probleme të Shëndetit Mendor në Burgje. Procesi i pilotimit është i parapare që të mundësohet përmasë tri aktiviteteve të parapara në këtë plan veprimi.

Pas pilotimit, krijimit të përvojës dhe konsolidimit të programit objektiva e treta e zbatimit të programit renditë aktivitet e nevojshme për fillimin e zbatimit të tij edhe në njësitë e tjera shëndetësore të burgjeve për nevojat e pacienteve psikiatrik. Përmes përzgjedhjes së stafit të trajnuar nga stafet ekzistuese, furnizimit me pajisje dhe shkëmbimit të përvojave me stafin e institucionit pilotues në ISHTPNV, plani i veprimit parasheh zgjerimin e programit.

Ndërsa i gjithë procesi i fillimit dhe i zbatimit të programit në vazhdimësi monitorohet përmes aktiviteteve të pasqyruara në objektiven e katërt të këtij plani të veprimit. Monitorimi synon të mirëmbaj kualitetin e shërbimeve dhe zbatueshmerinë e programit sipas udhëzuesit përmes monitorimeve të rregullta nga stafi i DSHB, raportimeve në baza të rregullta nga NJSHB përmes formës zyrtare të raportimit të rregullt lidhur me ecurinë e programit.

OBJEKTIVA 1							
PERZGJEDHJA DHE TRAJNIMI I STAFIT							
Nr.	Aktiviteti	Institucioni Përgjegjës	Institucioni mbështetës	Afati kohor për realizim të aktivitetit		Kosto	
				Muaji	Viti		
1.1	Përcaktimi i listës së kandidatëve për trajner	DSHB/MSH SHKK/MD IPFK ISSH		Janar	2024		
1.2	Trajnimi i Trajnerëve	Këshilli i Evropës	DSHB/MSH	Shkurt	2024		
1.3	Përzgjedhja e stafit për trajnim në zbatim të udhëzuesit nëpër NJSHB	Njësitë Shëndetësore të Burgjeve	DSHB	Mars	2024		
1.4	Organizimi i kaskadave për trajnimin e stafit në përvetësimin e njohurive për zbatimin e udhëzuesit	DSHB Këshilli i Evropës	SHKK	Qershor	2024		
OBJEKTIVA 2							
PILOTIMI I UDHEZUSIT NE ISHTPNV							
Nr.	Aktiviteti	Institucioni Përgjegjës	Institucioni mbështetës	Afati kohor për realizim të aktivitetit		Kosto	
				Muaji	Viti		
2.1	Përcaktimi i ekipes së profesionisteve brenda Njësisë Shëndetësore të	NJSHB Dubravë	DSHB SHKK	Mars	2024		

	Burgut për zbatimin e udhëzuesit						
2.2	Furnizimi me pajisjet e nevojshme për zbatimin e udhëzuesit sipas listës ne aneksit të dokumentit	DSHB/MSH SHKK/MD		Ambasada e Amerikës në Kosovës	Qershor	2024	
2.3	Shpërndarja e udhëzuesit te printuar dhe njoftimi i të gjithë stafit lidhur me aktivite	NJSHB Dubravë		DSHB SHKK	Qershor	2024	
2.4	Mbikëqyrjen e drejtpërdrejt e koordinatorit për shëndete mendore ne fazën e pilotimit	DSHB		SHKK		2024	
OBJEKTIVA 3							
ZGJERIMI I PROGRAMIT EDHE NE NJESITE E TJERA SHENDETESORE TE BURGJEVE							
Nr.	Aktiviteti	Institucioni Përgjegjës		Institucioni mbështetës	Afati kohor për realizim të aktivitetit		Kosto
					Muaji	Viti	
3.1	Përcaktimi i ekipeve te profesionisteve brenda Njesisve Shëndetësore te Burgut për zbatimin e udhëzuesit	NJSHB		DSHB SHKK		2025	
3.2	Furnizimi me pajisjet e nevojshme për zbatimin e udhëzuesit sipas listës në aneks të dokumentit	DSHB/MSH SHKK/MD				2025	

3.3	Angazhimi i profesionisteve nga ISHTPNV për shpërndarjen e pervojave nga procesi i pilotimit	DSHB		NJSHB Dubravë		2025	
OBJEKTIVA 4							
MONITORIMI DHE RAPORTIMI I ZBATIMIT TE PROGRAMIT							
Nr.	Aktiviteti	Institucioni Përgjegjës		Institucioni mbështetës	Afati kohor për realizim të aktivitetit		Kosto
					Muaji	Viti	
4.	Monitorimi sistematik i NJSHB-ve sipas planit të punës	DSHB				2025	
4.1	Themelimi i ekipit për monitorim të zbatimit të programit në kuadër të DSHB	DSHB			Qershor	2024	
4.2	Përpilimi i formës zyrtare të raportimit të rregullt lidhur me ecurinë e programit	DSHB		NJSHB			
4.3	Raportimi i rregullt i ekipeve multidisiplinare në secilin tremujor në DSHB	NJSHB				2025	